

FEDERATA BJESHKATARE E MAQEDONISË SË VERIUT

STATUTI

i Federatës Bjeshkatore të Maqedonisë së Veriut

(teksti i pastruar)

Shkup, Korrik 2022

Në bazë të nenit 104 të Ligjit të shoqatave dhe fondacioneve ("Fl.zyrtare e RM" nr.52, v.2010), Ligjit për sportin ("Fl.zyrtare e RM" nr.29/02, 66/04, 81/08, 18/11, 51/11, 6/16, 55/16, 61/16, 106/16 dhe 190/2016) dhe nenit 40 të Statutit të Federatës së Sporteve Bjeshkatore të Maqedonisë, Kuvendi në mbledhjen të mbajtur në dt.19.05.2018 mori Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Federatës së Sporteve Bjeshkatore të Maqedonisë dhe e konfirmoi tekstin e pastruar të Statutit.

Teksti i pastruar i Statutit të Federatës së Sporteve Bjeshkatore të Maqedonisë përmbledh: Statutin e Lidhjes së Sporteve Bjeshkatore të Maqedonisë nr.01-168/1, dt.09.12.1998, Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Lidhjes së Sporteve Bjeshkatore të Maqedonisë të dt.17 mars 2001, Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Lidhjes së Sporteve Bjeshkatore të Maqedonisë të dt.24.11.2002, Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Lidhjes së Sporteve Bjeshkatore të Maqedonisë nr.01-37/1, dt.31.03.2008, Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Lidhjes së Sporteve Bjeshkatore të Maqedonisë nr.01-29/1, dt.05.04.2011, Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit nr.01-33/1, dt.26.04.2014, Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit nr.01-39/3 dt.21.05.2016, Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të FSBM nr.01-58/4 dt.19.05.2018, Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të FSBM nr.01-51/3 dt.04.05.2019 dhe Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të FSBM nr.01-62/3 dt.04.06.2022.

Nr.01-58/1

Shërbimi profesional i FBMV

04.06.2022, Shkup

STATUTI

i Federatës Bjeshkatore të Maqedonisë së Veriut

(teksti i pastruar)

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Federata Bjeshkatore e Maqedonisë së Veriut – Shkup është shoqatë qytetarësh që e përbëjnë klubet sportive të sporteve bjeshkatore për të realizuar dhe përshtatur synimet dhe interesat e tyre të përbashkëta, si dhe për të ushtruar veprimtari dhe aktivitete bjeshkatarie.

Neni 2

Federata Bjeshkatore e Maqedonisë së Veriut – Shkup si shoqatë qytetarësh synimet dhe detyrat e veta i realizon në pajtim me Kushtetutën e RSM, Ligjin e sportit dhe këtë Statut.

Neni 3

Emërtimi i shoqatës së qytetarëve është: Federata Bjeshkatore e Maqedonisë së Veriut – Shkup. Kuptimi i shkurtër është FBMV – Shkup (në tekstin në vazhdim FBMV).

Neni 4

Selia e FBMV gjindet në Shkup, Rr.11 Tetori nr.42-a.

Federata organizohet dhe vepron në territorin e Republikës së Maqedonisë të Veriut.

Neni 5

FBMV vep faqen e ka: www.fpsm.org.mk.

FBMV adresën elektronike e ka: contact@fpsm.org.mk.

Neni 6

Federata Bjeshkatore e Republikës së Maqedonisë të Veriut është person juridik.

Neni 7

FBMV ka vulë rrethore dhe vulë katrore.

Vula rrethore përmban këtë tekst: Federata Bjeshkatore e Republikës së Maqedonisë të Veriut – Shkup.

Në qendër të vulës qëndron stema/logoja e FBMV.

Vula katrore e FBMV përmban këtë tekst: Federata Bjeshkatore e Republikës së Maqedonisë të Veriut, nr.e protokolit, data dhe Shkup.

Neni 8

FBMV ka stemën/logon e vet që ka formë rrethore, në skaje me shirit të kuq në të cilin qëndron teksti Federata Bjeshkatore e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup. Në mes të stemës qëndron kontura e Majës së Titos me kullën, masiv malor me skaje me shirit ngjyrë ari, mesi i zi dhe mbi të qielli i kaltërt, poshtë masivit fushë e gjelbërt me lum dhe djathtas tre pisha.

Për përdorim ndërkombëtar FBMV – Shkup ka stemën/logon në formë trekëndëshi me ngjyrë të gjelbër të errët. Në bazë qëndron e shkruar shkurtesa e organizatës “FPSM” me ngjyrë të gjelbërt të errët. Në shpinë të shkurtesës janë vizatuar kontura mali me ngjyrë të bardhë në kornizë të kuqe në formë të shkronjës “M”, ndërsa mbi të qëndron dielli i verdhë në kornizë të kuqe.

Neni 9

FBMV ka flamurin e vet me ngjyrë të kaltër të çelur, në mes, nga njëra anë qëndron stema e Federatës, ndërsa nga ana tjetër teksti me këto fjalë: “Federata Bjeshkatore e Maqedonisë së Veriut – Shkup”. Forma e flamurit është katërkëndëshe me përmasat 2 x 1. Skajet janë me oja bedeni ngjyrë të verdhë ari.

Neni 10

Federatën e prezenton dhe përfaqëson Kryetari i FBMV.

Neni 11

FBMV mund të asociojë edhe në korniza ndërkombëtare.

Neni 12

Puna e FBMV është publike.

Publiciteti i veprimtarisë sigurohet duke njoftuar organizatat themelore bjeshkatore të FBMV me të gjitha forma e punës, përmes qasjes në zbatimin e detyrave programore, duke dhënë raporte për punën e organeve dhe trupave të FBMV, për punën finaciare-materiale, etj.

Përfaqësuesve të shtypit, radios dhe televizionit u mundësohet qasje në të gjitha materialet e organeve të FBMV.

Kryesia dhe trupat përkatëse pranë FBMV u dërgojnë informata mjeteve të informimit publik.

SYNIMET DHE DETYRIMET E FEDERATËS

DHE MËNYRA E REALIZIMIT TË TYRE

Neni 13

Synimet e FBMV janë:

- t'i aktivizojë anëtarët e vet, si dhe të gjithë qytetarët, e sidomos rininë për të qëndruar dhe lëvizuar në natyrë, e veçanërisht në male;

- t'i njoftojë anëtarët e vet dhe qytetarët me bukuritë natyrore të vendit tonë, e sidomos me malet dhe pasurinë e tyre;
- tek anëtarët e vet dhe qytetarët të zhvillojë dashuri ndaj maleve;
- të punojë në drejtim të njoftimit dhe afrimit me pupuj tjerë në botë përmes bashkëpunimit me organizata bjeshkatore dhe simotra tjera në botë;
- t'i kultivojë traditat e së kaluarës historike dhe LNÇ;
- ta kultivojë dhe zhvillojë ndjenjën e bashkëjetesës dhe bashkëpunimit në mes popullit maqedon dhe nacionaliteteve;
- të zhvillojë dhe kultivojë frymë garuese në sportet rekreative dhe ata të lartat;
- ta trajnojë anëtarësinë me shkathtësitë speciale të bjeshkatarisë, siç janë: speleologjia, bjeshkataria e lartësive, ndihma e parë dhe shpëtimi në mal, bjeshkatari dimërore, e tj.;
- ta stimulojë arrijtjen e rezultateve të larta në të gjitha fushat e bjeshkatarisë;
- të krijojë kushte për përgaditje dhe organizim ekspeditash në bjeshkatari të lartësive nëpër masivet malore tek ne dhe jasht Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- ta nxisë ndërjegjen ekologjike tek anëtarët.
-

Neni 14

Detyrimet e FBMV janë:

- të veprojë për realizimin e synimeve të organizatës bjeshkatore në masovizimin e saj dhe edukimin e rinisë;
- ta afirmojë bjeshkatarinë në jetën shoqërore të tërësishme në vendin tone përmes pranisë së saj nëpër ndërmarrje, institucione, shkolla, komuna dhe universitete;
- të mbështesë organizime në mësimje, marshime, slete, llogorime, gara dhe hulumtime;
- çdo anëtar i organizatës bjeshkatore mund të jetë bartës i aktiviteteve të organizatës në të cilën i realizon të drejtat e veta qytetare, të ndikojë në programin dhe përbajtjen e veprimtarisë së organizatës;
- të kujdeset për informimin e gjithanëshëm të anëtarësisë me punën e vet;
- të kujdeset për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës bjeshkatore, siç janë: shtëpitë bjeshkatore, strehimoret, qendrat shpëtimtare, rrugicat, transversalet, si dhe objekte tjera rekreative e sportive bjeshkatore;
- të sigurojë apo të merr pjesë në gara sistemesh dhe ligash garuese të përpunuara në disciplina të sporteve bjeshkatore;
- të nxisë dhe mbështesë organizime garash masovike bjeshkatarije;
- të sigurojë punë demokratike dhe kontinuitet të organeve të veta;
- të sigurojë aftësim profesional të anëtarësisë për mes kurseve, seminareve, llogorimeve, kampingjeve, etj.;
- të botojë broshura dhe revista bjeshkatore profesionale e propagandistike;
- të zhvillojë bashkëpunim dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare;
- të bashkëpunojë me organe shtetërore, shoqëri dhe institucione tjera me qëllim të realizimit të synimeve të veta.

ANËTARËSIA

Neni 15

Anëtar organizate bjeshkatarie mund të bëhet çdo person që jeton në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili e pranon Statutin e FBMV.

Anëtar klubi mund të bëhet edhe një shtetas i huaj nën kushte në pajtim me ligjin.

Neni 16

Anëtar i FBMV bëhet duke aderuar në një klub sportiv bjeshkatar.

Neni 17

Anëtarë të FBMV mund të jenë të rregullt dhe të nderit.

Anëtarë të rregullt janë ata të cilët kanë paguar anëtarësinë.

Anëtarët e rregullt për kah grupmosha ndahen në:

- fëmijë deri në 14 vjeçarë,
- të rij nga 14 deri në 27 vjeçarë,
- të rritur mbi 27 vjeçarë.

Për anëtarësim të të miturve nevojitet pëlqim me shkrim nga prindi apo kujdestari.

Neni 18

Anëtarë nderi mund të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shtetas të huajë.

Anëtarët e nderit nuk mund të zgjedhin e as të zgjidhen në organet e FBMV, dhe as të marrin pjesë në marrjen e vendimeve.

Neni 19

Të drejtat e anëtarëve janë:

- aktivisht të marrin pjesë në punën e organizatës, të propozojnë dhe të marrin pjesë në marrjen e vendimeve;
- të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjitha organet e FBMV për mes klubeve sportive;
- të marrin pjesë në të gjitha llojet e aktiviteteve bjeshkatore sipas mundësive;
- t'i shfrytëzojnë të gjitha privilegjet që FBMV ua jep anëtarëve të vet.

Neni 20

Detyrimet e anëtarëve janë:

- t'i përmbahen statutit të klubit sportive ku bëjnë pjesë;
- rregullisht të paguajnë anëtarësinë;
- t'i përmbushin detyrat dhe vendimet e FBMV dhe të klubeve sportive;
- të marrin pjesë në të gjitha llojet e aktiviteteve bjeshkatore sipas mundësive të tyre;
- ta ruajnë nderin e organizatës dhe anëtarëve;
- të ndihmojnë në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ruajtje e objekteve bjeshkatore;
- t'i ruajnë shenjat bjeshkatore, florën dhe faunën e maleve;

- t'i kujtvojë marrëdhënjet e mira ndërnjerëzore dhe solidaritetin Brenda FBMV.

Neni 21

Anëtarësimi në organizatat bjeshkatore (klubet) pushon:

- me çregjistrim,
- me shlyerje për shkak të moskryerjes së detyrimeve nga neni 20;
- me vendim të klubit sportiv për përjashtim.

Vendimin për përjashtim klubi sportiv e dërgon te FBMV, për mes të cilit u dërgohet të gjitha klubeve sportive të FBMV.

Anëtarin e përjashtuar nuk mund ta pranojë asnjë klub sportiv i FBMV për aq kohë për sa është i përjashtuar.

Anëtari i përjashtuar mund të rianëtarësohet pas kalimit të dënimit.

PARIMET BAZË ORGANIZATIVE

Neni 22

Për të realizuar nevojat e veta lidhur me aktivitetet dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave në fushën e bjeshkatarisë si sport, qytetarët mundën lirisht dhe vullterarisht të bashkohen dhe të formojnë shoqata sportive bjeshkatarie në pajtim me kushtet dhe mënyrat të caktuara me ligj dhe me këtë Statut.

Organizatat bazë bjeshkatore organizohen si klube sportive.

Organizatat bazë bjeshkatore konstituohen në kuadër të një organi shtetëror, ndërmarrjeje, enti, shkolle, universiteti, apo jashtë këtyreve institucione.

Për themelimin e organizatave bazë bjeshkatore nevojiten më së paku pesë (5) qytetarë madhorë, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Organizatat bazë bjeshkatore nxjerrin statut.

Neni 23

Klubet sportive, si persona juridikë, mund të formojnë shoqëri me pëprgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionere për të ushtruar veprimari sportive me qëllim të realizimit të synimeve, interesave dhe aktiviteteve të saja, si dhe për finansimin e funksioneve të saja.

Neni 24

Përmbajtja e punës së klubit sportiv qëndron në realizimin e synimeve dhe detyrimeve të parapara me Statutin e FBMV.

Neni 25

Klubi sportiv evidentohet në FBMV.

Klubi sportiv, në pajtim me ligjin, detyrimisht regjistrohet në Regjistrin Qëndror të RMV dhe në Agjensionin për rini dhe sport.

Neni 26

Klubi sportiv që të mund të evidentohet në FBMV është e nevojshme të ketë të paktën një anëtar i cili ka licencë apo të ketë dhënë provim për udhëheqës në bjeshkë, apo instruktor i sportit përkatës të bjeshkatarisë, sipas programit të Qendrës për aftësim profesional pranë FBMV.

Nëqoftëse klubi sportiv nuk ka anëtar të licencuar apo me provim të dhënë sipas alinesë së mësipërme, i njëjti mund të regjistrohet nëqoftëse ka njeri të tillë nga një klub sportiv tjetër, i cili do t'i udhëheqë aktivitetet e këtij klubi sportiv deri në aftësimin e një anëtari të klubit apo dhënen e provimit nga alineja një e këtij neni, por më së voni deri në një vit nga regjistrimi i klubit.

Neni 27

Për përmbushje më të suksesshme të synimeve dhe detyrimeve të organizatës bjeshkatore, organizatat bazë bjeshkatore në territorin e një komune, qyteti, universiteti dhe rajoni bashkohen në ligë të komunës, qytetit dhe universitetit.

Për formimin e një lige komunale, qyteti dhe universiteti, kusht është të jenë më së paku tre (3) organizata bazë bjeshkatore.

Neni 28

Baza për konstituimin e organeve të FBMV janë klubet sportive të evidentuar në FBMV.

Neni 29

Ligat e komunës, qytetit dhe universitetit për sportet bjeshkatore i inicojnë, drejtojnë, bashkojnë, koordinojnë dhe kontrollojnë aktivitetet e organizatave bazë bjeshkatore.

Veprimtarinë e rregullojnë me statutin e vet, i cili është në pajtueshmëri me këtë Statut.

Neni 30

Organizata bazë bjeshkatore, liga e komunës, qytetit dhe universitetit mund të përjashtohen nga FBMV në raste kur nuk i zbaton vendimet dhe rekomandimet e FBMV dhe në rast se dy vjet rradhazi nuk marrin pullat bjeshkatore.

Neni 31

Organizatat bazë bjeshkatore (klubet sportive) në çdo fillimviti, e më së voni deri në fillim të muajti prill të vitit në vijim në llogarinë rrjedhëse të FBMV bëjnë pagesën e anëtarësisë vjetore në lartësinë e shumës që përcaktohet me vendim të Kryesisë së FBMV.

Klubet që nuk do të bëjnë pagesën e mësipërme deri në 1 prill, nuk mund të marrin pjesë në punën e mbledhjeve të Kuvendit, të votojnë e as të votohen nëpër organet e Federatës.

Klubet të cilët dy vjet rradhazi nuk e paguajnë anëtarësinë, ndërsa për vitin e tretë e paguajnë në fillim të vitit, duhet ta paguajnë edhe anëtarësinë për dy vitet e kaluara që të konsiderohen për anëtarë si gjithë të tjerët dhe të mund të zgjedhin e të zgjidhen në organet e FBMV.

Me këtë pagesë organizata bazë bjeshkatore fitojnë të drejtën të marrin pulla anëtarësie varsisht nga numri i anëtarëve të tyre pa asnjë detyrim pagese për pullën e marrë dhe të njëjtat t'ua japin anëtarëve të vet me një çmim që e cakton organi drejtues e tyre.

Neni 32

Mjetet e grumbulluara nga anëtarësia FBMV do t'i shfrytëzojë me destinacion dhe do t'u ndahen organizatave bazë bjeshkatore, të cilat kontribuojnë për zhvillimin e sportit të bjeshkatarisë.

Mënyra, shuma dhe përkushtimi i ndarjes së këtyre mjeteve organizatave bazë bjeshkatore do të përcaktohet me rregullore të veçantë.

Neni 33

FBMV lëshon libresa anëtarësie.

Çmimin i libresës së anëtarësisë e caktot Kryesia e FBMV me vendim.

Çmimi i libresës së anëtarësisë nuk mund të jetë më i lartë se kostoja për shtypjen e saj.

Neni 34

Organizatave bazë bjeshkatore gjatë dhënjes së pullave të anëtarësisë për vitin në vijim detyrimisht i sigurojnë anëtarët e vet për rast rreziku në sport.

Neni 35

FBMV është organizata e vetme në Republikën e Maqedonisë së Veriut e kualifikuar për të organizuar aksione republikane bjeshkatarie.

Organizimin teknik mund t'ua besojë klubeve sportive sipas kushteve dhe kriteriumeve të caktuara.

Neni 36

Për realizimin e synimeve dhe detyrimeve, interesave dhe aktiviteteve, si dhe për finansimin e funksioneve të veta FBMV dhe organizata tjera bjeshkatore mund të formojnë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqatë aksionere.

Karakterit dhe parimet e punës përcaktohen me aktin e themelimit të tyre.

Fitimet dhe të ardhurat që realizohen nga puna mund të përdoren vetëm për mbajtjen dhe realizimin e synimeve dhe detyrimeve të caktuara me këtë Statut.

ADMINISTRIMI I FBMV

Neni 37

Me FBMV administrojnë anëtarë të propozuar nga klubet bjeshkatore.

Të drejtar dhe detyrimet e përfaqësuesit janë:

- i barabartë të merr pjesë në punimet e FBMV,
- të propozojë zgjidhje me interes të përbashkët,

- t'i përputhë qëndrimet e veta me ata të përfaqësuesve tjerë,
- të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e FBMV,
- në FBMV t'i përfaqësojë interesat dhe qëndrimet e klubit që përfaqëson apo anëtar i të cilit është,
- të punojë për zhvillimin dhe përparimin edhe të aktiviteteve tjera të përbashkëta që dalin nga Statuti, synime dhe detyrime programore si dhe nga vendimet dhe konkluzat e marra,
- t'i zbatojë dispozitat e këtij Statuti,
- rregullisht ta njoftojë klubin e vet për punën e organeve të FBMV.

ORGANET E FBMV

Neni 38

Organe të FBMV janë:

- Kuvendi,
- Kryesia,
- Kryetari,
- Këshilli mbikqyrës dhe
- Gjyqi i nderit.

Kuvendi

Neni 39

Organi më i lartë i FBMV është Kuvendi.

Kuvendi konstituohet me nga një përfaqësues nga të gjithë anëtarët e rregullt të FBMV.

Kuvendi zgjidhet për çdo katër (4) vjet.

Kuvendi mund të jetë zgjedhor edhe në afat më të shkurtër se katër vjet nëse bëhet thirrje për kuvend zgjedhor të jashtëzakonshëm, kjo me kërkesë me shkrim nga një e treta e përfaqësuesve të Kuvendit ose nga një e treta e anëtarëve të regjistruar, gjegjësisht klubeve sportive.

Neni 40

Kuvendi ka këto kompetenca:

- nxjerr statutin, programet dhe akte të tjera,
- miraton raportin vjetor, udhëzime dhe plan pune, dhe këta i shpall në web faqen e vet,
- miraton raport financiar, bilans vjetor, plan financiar, dhe këta i shpall në web faqen e vet,
- vendos për ndërimin e synimit të shoqërimit,
- vendos për formim dhe shuarje të degëve dhe formave tjera organizative të FBMV,
- vendos për ndryshime statusore të shoqatës dhe për anëtarësim në lidhje simotra dhe organizata simotra ndërkombëtare,
- konstaton pranimit të anëtarëve të rij dhe pushim anëtarësimi,

- zgjedh organet e FBMV,
- vendos për shuarjen e të qenit të FBMV, me shumicën prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve,
- vendos edhe për çështje tjera, të cilat nuk janë në kompetencë të trupave tjera të FBMV, si dhe vendos për raportet e Kryesisë dhe të Këshillit mbikqyrës,
- zgjedh anëtarë të këshillim mbikqyrës,
- zgjedh anëtarë të gjyqit të nderit,
- shkarkon organet e FBMV,
- informohet me nxjerrjen e rregulloreve dhe akteve tjera lidhur me punën e FBMV që i nxjerr Kryesia.

Neni 41

Kuvendi punon në mbledhje.

Kuvendi mban mbledhje një herë në gjashtë (6) muaj, apo më së paku një herë në vit.

Mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit mund të mbahet me kërkesë me shkrim nga një e treta e anëtarëve të Federatës.

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të alinesë tre të këtij neni mbahet më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës.

Neni 42

Mbledhjen e Kuvendit e thërret Kryetari i Kryesisë.

Nëse kryetari i Kuvendit në afat prej 14 ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit nuk thërret mbledhje, mbledhjen e thërret Kryesia, këshilli mbikqyrës apo inicuesit.

Neni 43

Anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e Këshillit mbikqyrës dhe Gjyqit të nderit marrin pjesë në punimet e Kuvendit, pa të drejtë vote, kur shqyrtohen raportet që ia kanë dërguar Kuvendit.

Neni 44

Në Kuvend vendimet merren me votim të hapur, ndërsa për çështje të caktuara vendimet mund të merren me votim të fshehtë.

Çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë në një votë.

Neni 45

Kuvendi i FBMV me fuqi të plotë merr vendime nëse në të janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përfaqësuesve.

Puna e Kuvendit rregullohet me rregullore pune.

Neni 46

Kuvendi vendimet i merr me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm.

Kryesia

Neni 47

Kryesia numëron 11 anëtarë.

Anëtarët e Kryesisë zgjidhen me mandat katërvjeçar.

Në Kryesi nuk mund të ketë dy anëtarë nga i njëjti klub sportiv.

Komisioni zgjedhor prej propozimeve të marra nga klubet bjeshkatore për anëtarë të Kryesisë përgadit listën e kandidatëve për anëtarë të mundshëm të Kryesisë së FBMV, të cilën listë ia paraqet Kuvendit që i zgjedh. Për të patur transparencë dhe konkurrencë më të madhe, në listën e kandidatëve parapëlqehet të ketë nga dy kandidatë për një vend në Kryesi.

Kuvendi zgjedhjen e kandidatëve e bën me votim të fshehtë. Përfaqësuesit e deleguar të klubeve bjeshkatore në listat e kandidatëve për anëtarë të mundshëm të Kryesisë së FBMV rrethojnë vetën 10 numra para emrave të kandidatëve të mundshëm për anëtarë të Kryesisë së FBMV. Për anëtarë të zgjedhur për në Kryesi llogariten ata 10 kandidatë që kanë fituar numër më të madh votash.

Nëse kandidatë të caktuar kanë fituar numër të njëjtë votash, votimi për ata kandidatë përsëritet.

Gjatë propozimeve për kandidatë për anëtarë të Kryesisë, organizatat bjeshkatore/klubet mund të propozojnë anëtarë të cilët kanë më së paku pesë vjet antarësi aktive dhe që kanë treguar aftësi për nisma dhe për punë ekipore në interes të bjeshkatarisë.

Përfaqësuesit e deleguar nga klubet bjeshkatore, në Kuvend, gjatë votimit për kandidatët për anëtarë të mundshëm të Kryesisë detyrimisht duhet të kenë parasysh përfaqësimin rajonal në Kryesi.

Neni 47-a

Mandati i anëtarëve të Kryesisë pushon në rastet në vijim:

- me kalimin e mandatit,
- me kërkesë të tij,
- me humbje të përhershme të aftësisë për të ushtruar funksionin e anëtarit të kryesisë,
- kur me aktgjykim të plotëfuqishëm për një vepër penale i shqiptohet dënim pa kusht në kohëzgjatje më së paku gjashtë muaj burgim,
- pas një njoftimi nga klubi amë, i cili e ka deleguar, se me vendim të plotëfuqishëm është i përjashtuar nga anëtarësia,
- në rast sëmundje me kohëzgjatje mungon në më shumë se tre mbledhje të kryesisë,
- në rast vdekje.
-

Neni 48

Puna e Kryesisë rregullohet me rregullore.

Kryesia në mbledhje mund të punojë nëse janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve (tetë anëtarë), ndërsa vendimet i merr me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

Neni 49

Kryesia për punën e vet është përgjegjëse para Kuvendit të FBMV.

Kryesia mbledhet sipas nevojës.

Mbledhjen e Kryesisë e thërret Kryetari.

Propozim për mbledhje të Kryesisë mund të parashtrojë çdo klub sportiv, anëtar i Kryesisë dhe Këshilli mbikqyrës.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes dhe e punimeve të Kryesisë përcaktohet me rregullore pune.

Neni 50

Me mbledhjet e Kryesisë udhëheq Kryetari.

Neni 51

Kryesia i ka këto kompetenca:

- i përgadit mbledhjet e Kuvendit,
- e përgadit projekt statutin dhe vendimet tjera që duhet t'i nxjerrë Kuvendi.
- e zbaton politikën, konkluzat dhe vendimet që i nxjerr Kuvendi,
- mund të formojë shërbim profesional dhe të ushtrojë kontroll mbi punën e tij,
- administron dhe përgjigjet për administrimin me pronën e FBMV,
- përgadit raport vjetor apo periodik për punën e vet,
- përgadit plan financiar dhe përlllogaritës,
- e cakton lartësinë e pagesës për anëtarësi në FBMV,
- kryen punë teknike rreth rregjistrimit të shoqatave/klubeve,
- zgjedh trupa punuese të kryesisë,
- u shqipton vërejtje klubeve sportive, ligave dhe anëtarëve që nuk u përmbahen dispozitave të Statutit të FBMV,
- nxjerr rregullore dhe akte të tjera për punën e vet dhe punën e trupave punuese të saj , si dhe për punën e FBMV,
- kryen punë teknike lidhur me shlyerjen e ndonjë klubi splortiv nga FBMV,
- e drejton procedurën për të mbajtje mbledhje të jashtëzakonshme të FBMV,
- zgjedh përfaqësues nëpër klubet sportive dhe organizata tjera,
- nxjerr kalendar për aksione dhe kujdeset për zbatimin e tij,
- merr vendime për të formuar komisione e trupa tjerë dhe e orienton punën e tyre,
- merr vendime për shpërblime, lavdata e mirënjohje,
- merr vendime për furnizim dhe tjetërsim të mjeteve bazë për punën e FBMV, për botime me literaturë profesionale dhe për nevoja tjera,
- në kushte gjendjeje të jashtëzakonshme kur Kuvendi fizikisht nuk mund të mbledhet, Kryesia mund të nxjerrë vendime, të cilat kur të mundësohet gjendja, do t'i konfirmojë Kuvendi,

Kryesia për të gjitha veprimet e ndërmarra, të realizuara dhe të porealizuara e informon Kuvendin e FBMV dhe para tij përgjigjet.

Neni 52

Për aktivitete të pjesërishme të organizatës bjeshkatore, Kryesia e FBMV formon trupa të veta të veçanta – komisione, si vijojnë:

- **Komision për udhëheqës në bjeshkë**, i cili në fushëveprimin e tij, mes tjerash zhvillon trajnim për aftësim për udhëheqës në bjeshkë, me ç'rast, pas dhënjes së provimit profesional jep licensë;
- **Komisioni për shtigje bjeshkatore**, i cili në fushëveprimin të tij, mes tjerash zhvillon trajnim për aftësim për markacistë, me ç'rast pas dhënjes së provimit profesional jep licensë;
- **Komisioni për shtëpitë dhe objektet në bjeshkë;**
- **Komisioni i rinisë**, i cili në fushëveprimin e tij, mes tjerash zhvillon trajnim për aftësim për liderë rinorë bjeshkatarë, me ç'rast pas dhënjes së provimit profesional jep licensë;
- **Komisioni për bjeshkatari të lartësive dhe ekspedita**, i cili në fushëveprimin e tij, mes tjerash organizon ekspedita dhe bjeshkatari të lartësive brenda dhe jasht shtetit;
- **Komisioni për orientim në bjeshkë;**
- **Komisioni për skajraning;**
- **Komisioni për teknika bjeshkatarie dhe**
- **Komisioni për turno skijim.**

Zgjedhja, përbërja dhe fushëveprimi i aktivitetit të komisioneve caktohet me rregullore përkatëse, të cilkat i përgadit komisioni, ndërsa i nxjerr kryesia e FBMV.

Neni 53

Në komunikimin juridik dhe para personave të tretë FBMV e prezenton dhe përfaqëson kryetari.

Kryetari i FBMV njëherit është edhe kryetar i kryesisë së FBMV.

Neni 53-a

Personi që e prezenton federatën mund të rizgjidhet rradhazi më së shumti dy herë, por pas kalimit të periudhës të më se një mandati të plotë, ai mund të zgjidhet përsëri.

Nëse në momentit e pushimit të mandatit të personit që e prezenton federatën zhirollagaria e federatës është e bllokuar më së paku 30-të ditë, personi mandatit i të cilit pushon nuk mund të rizgjedhet.

Votimi rreth propozimeve për kandidati për kryetar rregullisht është i hapët, por kuvendi zgjedhor mund të vendosë që votim i të jetë i fshehtë (me fletëvotime), me ç'rast pranohet ai propozim për të cilin kanë votuar më se gjysma e përfaqësuesve të pranishëm.

Kryetari zgjidhet vetëm nga anëtarët të propozuar nga lista e klubeve bjeshkatore përcjellur me një arsyetim të caktuar për kandidatin e propozuar.

Kandidati që fiton numër më të madh votash llogaritet për kryetar i zgjedhur për mandatin katëvjeçar të rradhës.

Nëse dy kandidatë kanë të njëjtin numër votash, votimi për ta përsëritet derisa njëri nga ata nuk fiton numër më të madh votash.

Neni 53-b

Në rast mungese Kryetarin e zëvendëson Zëvendëskryetari.

Zëvendëskryetari zgjidhet nga rradhët e anëtarëve të Kryesisë së FBMV sipas propozimit të Kryetarit. Anëtari i Kryesisë i cili është propozuar për zëvendëskryetar llogaritet se është zgjedhur nëse për të votojnë shumica e numrit të anëtarëve të Kryesisë.

Zëvendëskryetari në rast mungese të Kryetarit e zëvendëson Kryetarin me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

Neni 54

Kompetencat e Kryetarit:

- e prezenton dhe e përfaqëson FBMV,
- është përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Statutit,
- e thërret Kryesinë dhe udhëhet me punimet e saj,
- kujdeset për punën e Federatës,
- i nënshkruan rregulloret, aktet dhe vendimet që i nxjerr Kryesia,
- kryen edhe punë tjera të cilat i jepen në kompetencë,
- për të gjithë punët e sipërmarra, të realizuara e të pa realizuara, Kryetari e informon Kryesinë e FBMV dhe para saj përgjigjet,

Në vendime të caktuara të Kryesisë, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e Statutit, Kryetari për zbatimin e tyre mund të vejë veto.

Neni 54-a

Mandati i kryetari pushon në këta raste:

- me kalimin e mandatit,
- me kërkesë të tij,
- me humbje të përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit të kryetarit,
- me aktgjykim të plotëfuqishëm i shqiptohet dënim me burgim pa kusht në kohëzgjatje më së paku gjashtë muaj,
- nëse për shkak të sëmundjes me kohëzgjatje mungon më shumë se gjashtë (6) muaj për çka nuk është në gjendje të thërrasë mbledhje të Kryesisë,
- në rast vdekje.

Këshilli mbikqyrës

Neni 55

Këshilli mbikqyrës përbëhet prej tre anëtarësh dhe dy zëvendësve, të cilët i zgjedh Kuvendi.

Mandati i anëtarëve është katër vjet me mundësi për rizgjedhje.

Anëtarët zgjedhin kryetar nga rradhët e veta.

Këshilli kujdeset për zbatimin e Statutit dhe akteve tjera, ushtron mbikqyrje në zbatimin e direktivave, aktvendimeve, vendimeve të Kuvendit, në punët finasiare e materiale të FBMV.

Këshilli mbledhet më së paku një herë në vit.

Anëtarët e organit kanë të drejtë të jenë të pranishëm në mbledhjet e Kryesisë për mes një anëtari të vet.

Këshilli ka të drejtë që Kryesisë t'i kërkojë të thërrasë Kuvend në lidhje me mbikqyrjen/kontrollën e kryer rreth punës materiale e finaciare të Federatës.

Këshilli për të gjithë punët e ndërmara, të realizuar e të porealizuara, e informon Kuvendin e FBMV dhe përgjigjet para tij.

Neni 55-a

Mandati i anëtarëve të Këshillit mbikqyrës pushon në rastet si më poshtë:

- me kalimin e mandatit,
- me kërkesën e tij,
- me humbje të përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit mbikqyrës,
- me aktgjykim të plotëfuqishëm i shqiptohet dënim me burgim pa kusht në kohëzgjatje më së paku gjashtë muaj,
- pas një njoftimi nga klubi amë, i cili e ka deleguar, se me vendim të plotëfuqishëm është përjashtuar nga anëtarësia,
- në rast sëmundje në kohëzgjatje mungon në më shumë se tre mbledhje të Këshillit mbikqyrës,
- në rast vdekje.

Gjyqi i nderit

Neni 56

Gjyqi i nderit është kompeten të vendosë për moszbatimin ose zbatimin gabimisht të detyrave të caktuara nga ana e anëtarit të ndonjë klubi, apo vetë klubit i cili është anëtar i FBMV.

Gjyqi i nderit vepron si organ i veçantë ndaj të gjithë organizatave bjeshkatore dhe punon sipas rregullores që e nxjerr Kryesia e FBMV.

Gjyqi i nderit përbëhet prej tre anëtarësh dhe dy zëvendësve, të cilët i zgjedh Kuvendi.

Anëtarët në mes vedi zgjedhin kryetarin për mandat katërvjeçar.

Neni 56-a

Mandati i anëtarëve të Gjyqit të nderit pushon në këta raste:

- me kalimin e mandatit,
- me kërkesën e tij,
- me humbje të përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Gjyqit të nderit,
- me aktgjykim të plotëfuqishëm i shqiptohet dënim me burgim pa kusht në kohëzgjatje më së paku gjashtë muaj,
- pas një njoftimi nga klubi amë, i cili e ka deleguar, se me vendim të plotëfuqishëm është i përjashtuar nga anëtarësia,

- në rast sëmundje me kohëzgjatje mungon në më shumë se tre mbledhje të Gjyqit të nderit,
- në rast vdekje.

Shërbimi profesional i FBMV

Neni 57

Për kryerje të punëve administrative-profesionale, ndihmëse dhe të tjera të ngjajshme me to, që janë në interes të përbashkët për realizimin e synimeve dhe detyrimeve të FBMV, formohet shërbimi profesional.

Neni 58

Të drejtat, detyrime dhe përgjegjësitë e shërbimit profesional rregullohem me me akt të veçantë, të cilin e nxjerr Kryesia (në pajtim me ligjet).

Neni 59

Mjetet për punën e shërbimit profesional caktohen me plan financiar për çdo vit.

Neni 60

Administratori detyrimisht është i pranishëm në të gjithë mbledhjen e Kryesisë dhe është përgjegjës për të gjithë punët administrative, por nuk ka të drejtë vote.

Të gjitha shpenzimet që i bën administratori-arkëtar dhe personat profesionale tjerë të shërbimit profesional doemos duhet të miratohen dhe paraprakisht të nënshkruhen nga Kryetari ose nga nënshkruesit. Ai detyrimisht është i pranishëm në mbledhjet pa të drejtë vote, por ka të drejtë të merr pjesë në shqyrtimin e çështjeve financiare dhe atyreve administrative e teknike.

Administratori e udhëheq dhe e ruan arkivin e FBMV.

Shërbim shpëtimi malor

Neni 61

Në kuadër të FBMV organizohet Shërbim shpëtimi malor (në tekstin në vazhdim SHSHM).

SHSHM ka për detyrë: të ndërmarrë veprime shpëtimi në tokë, në ujë dhe në ajër në kuptimin e kërkimit të personave të zhdukur dhe shpëtimin e të lënduarve.

Në rastet kur ndërmerren veprime shpëtimi nga SHSHM, klube sportive që administrojnë me shtëpitë bjeshkatore detyrohen të lëshojnë lokal për ta shfrytëzuar SHSHM.

Neni 62

Anëtarë SHSHM mund të jenë bjeshkatarë me përvojë, alpinistë, speleologë që kanë që kanë përvojë të gjatë dhe që kanë kryer kurse.

SHSHM disponon me pajisje të duhur.

Organizimi dhe mënyra e punës të SHSHM rregullohet me akt të FBMV.

Komisioni i shtëpitë malore

Neni 63

Në kuadër të FBMV organizohet Komision i shtëpive dhe objekteve bjeshkatore (KSHM). Anëtarë të komisionit janë anëtarët që i kanë propozuar klubet që e përbëjnë Federatën me mandat katërvjeçar.

Komisioni kryen punë që kanë të bëjnë me shtëpitë dhe objektet mallore, në kuptimin e dhënjes së shtëpive me qira, lidhjen e kontratave, mirëmbajtjen e shtëpive, sanimin e tyre, rregullimin e marrëdhëneve pronësore juridike në lidhje me shtëpitë, etj.

Mënyra e punës së KSHB rregullohet me akt të Federatës.

Nenbi 64

FBMV administron me objektet bjeshkatore drejtpërdrejt dhe tërthorazi me ata shfrytëzues i të cilëve është një klub sportiv apo një subjekt tjetër, me të cilin lidhet kontratë e veçantë.

Klubet sportiv e bjeshkatore që administrojnë me shtëpi malore në pronësi të FBMV janë të detyruar të njëjtët t'i sigurojnë në emër të FBMV.

Klubet sportive, ligat apo trupat tjerë koordinues që administrojnë me ndonjë objekt të veçantë mund ta japin atë me qira ose në një bazë tjetër t'ia japin në shfrytëzim dikujt tjetër, por paraprakisht me vendim pëlqimi të dhënë nga FBMV.

Kryesia e FBMV detyrohet të marrë vendim për ndërprerje të kontratës për shfrytëzim të një objekti bjeshkatar nëse konstaton se i njëjti nuk shfrytëzohet për destinacionin e tij si shtëpi malore apo objekti nuk është i mirëmbajtur në rregull.

Neni 65

Marrëdhënjet pronësore juridike dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve nga objektet malore të dhëna me qira rregullohen me kontratë të veçantë në mes FBMV dhe shfrytëzuesit të drejtpërdrejtë.

Neni 66

Mjetet e marra në bazë dëmshpërblimi për rast djegëje, dëmtimi ose sendet të tjetërsuara të organizatave bjeshkatore, mund të shfrytëzohen vetëm për ndërtim, renovim ose furnizim me sende të tilla.

Neni 67

Kryesia e FBMV me vendim të veçantë dhe në mënyrë të caktuar për rimbursim përcakton shfrytëzimin e lokaleve malore për shërbim-shpëtimin për mbajtjen e kurseve, seminareve dhe përgaditjen e ekipeve që synojnë rezultate të larta.

FINANSIMI I FBMV DHE MJETET MATERIALE TË FEDERATËS

Neni 68

Burimet e mjeteve finaciare të FBMV janë:

- mjete nga anëtarësia,
- mjete nga të ardhurat e objekteve malore,
- mjete nga taksat turistike të inkasuara nëpër shtëpitë malore,
- mjete nga buxheti I RMV, të cila shfrytëzohen për mes Agjensisë për rini dhe sport,
- dhurata dhe donacione.

Neni 69

Pasurinë e FBMV e përbëjnë sendet që janë në pronësi të FBMV, si vijojnë:

- objektet,
- lokalet,
- pajisjet,
- inventaret,
- fondet,
- mjete tjera në të holla.

Neni 70

Shfrytëzimi dhe përdorimi i mjeteve të FBMV të fituar në bazë të nenit paraparak zbatohet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj dhe statut.

Neni 71

Për shfrytëzimin dhe përdorimin e mjeteve vendosin organet e FBMV, në pajtim me kompetencata të caktuara me këtë Statut, të cilët marrin masa për shfrytëzim ekonomikisht të arsyeshëm dhe për të penguar dhe evituar paligjshmëritë.

Neni 72

Organi mbikqyrës ushtron kontroll mbi zbatimin e dispozitiva të Statutit dhe kontrollon shfrytëzimin me destinacion dhe shfrytëzimin e mjeteve dhe të ardhurave të FBMV.

Neni 73

FBMV nxjerr plan vjetor financiar për të ardhurat dhe shpenzimet me të cilat administron.

Të ardhura:

- nga anëtarësia,
- nga qiratë e shtëpive malore,
- nga donacionet,
- nga buxheti,
- nga veprimataria botuese,
- nga shoqëritë tregtare,
- dhe nga burimet tjera.

Shpenzime:

- për aktivitetet e FBMV,
- për veprimtari botuese,
- për fonte me destinacion,
- rroga dhe shpenzimet të përbashkëta për të punësuarit,
- shpenzime material në punën e FBMV.

PËRGJEGJËSIA PËR DETYRIMET

Neni 74

FBMV për detyrimet e veta përgjigjet me të gjithë pasurinë dhe mjetet e veta.

Anëtarët e organeve të FBMV kanë përgjegjësi personale dhe të pakufizuar për detyrimet e veta ndaj FBMV, për keqpërdorim të mjeteve të FBMV, për arritje synimesh të cilët për ata si individë janë të ndaluara ose për keqpërdorim të FBMV si person juridik për t'u shkaktuar dëm kreditorëve të vet.

PËRGJEGJËSIA PËR DËMTIM

Neni 75

Anëtarët e organeve të FBMV dhe Kryetari I FBMV janë përgjegjës solidarë për dëmtim ndaj FBMV të shkaktuar nga puna e tyre, nëse ai është shkaktuar nga pakujdesia e madhe ose qëllimisht për të shkaktuar dëm, përveç në raste kur gjatë vendimmarrjes mendimin e tyre e ndajnë në procesverbal apo kur nuk marrin pjesë në vendimmarrje.

Kërkesën për rimbursim të dëmit e parashtron kryesia e FBMV.

SHUARJA E FBMV – Shkup

Neni 76

FBMV shuhet së qeni në këta raste:

- kur në Kuvend me shumicë prej dy të tretave merret vendim për shuarje të të qenurit,
- kur kalon kohë dyfish më shumë nga koha e paraparë për të mbajtur mbledhje të Kuvendit, dhe ajo nuk është mbajtur,
- kur në dy vite rradhazi nuk është parashtruar bilans në pajtim me ligjin,
- në rast të ndryshimit statusor që parashifet shuarja e të qenit,
- me vendim të gjyqit kompetent,
- në raste tjera të parapara me Ligjin e shoqërive dhe fondacioneve.

Në rastet nga pikave 2 dhe 3 të alinesë 1 të këtij neni, vendim për shuarje merr gjykata kompetente me propozim të Kryetarit dhe anëtarëve të organeve të FBMV nëse nga Kuvendi nuk ka vendim për shuarje.

PROCEDURA RRETH PASURISË SË FBMV NË RAST TË SHUARJES SË SAJ

Neni 77

Në rast të shuarjes së FBMV e gjithë pasuria do t'u takojë anëtarëve të Federatës, përkatësisht klubeve sportive të Republikës së Maqedonisë së Veriut me të njëjtin proporcion, me të cilin marrin pjesë në finansimin e FBMV.

MIRËNJOHJET PUBLIKE

Neni 78

Për merita të veçanta për zhvillimin dhe afirmimin e organizatës bjeshkatore, si dhe për arritje të rezultateve të larta, ndahen mirënjohje publike.

Dispozitat më të përafërta për ndarjen e mirënjohjeve caktohen me Rregulloren për ndarjen e mirënjohjeve publike.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 79

Interpretim autentik të dispozitave të këtij Statuti jep Kryesia e FBMV dhe i njëjti hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij.

Neni 80

Ndryshime dhe plotësime të këtij Statuti bëhen sipas mënyrës me të cilën ai është nxjerrë.

Neni 81

Klubet sportive dhe ligat statutet e veta do t'i përshtasin me këtë Statut në kuvendet e para, e më së voni në afat prej një viti nga dita e nxjerrjes së këtij Statuti, dhe nga një ekzemplar të dërgojnë në FBMV.

Nr.01-58/1

Federata e Bjeshkatarisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut – Shkup

Dt. 04.06.2022

Kryetari

Zoran Çitkushev